



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTVENDIM

Nr. /2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 102/2017,
“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar Demokrat dhe Grupit Parlamentar të Pavarur,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore”, të ndryshuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika II ndryshon si vijon:

“II. Komisioni ka për detyrë:

1. Të hartojë ndryshime të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e plotë të rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për tre zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, si dhe të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet.
2. Të verifikojë aftësinë e të gjitha institucioneve shtetërore që kanë rol në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore për:
 - a) Të garantuar një proces të rregullt e të barabartë zgjedhor mes të gjithë forcave politike pjesëmarrëse;
 - b) Marrjen e masave dhe ashpërsimin e dënimeve për të luftuar shitblerjen e votës;
 - c) Të eliminuar çdo formë të keqpërdorimit të burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore;
 - d) Të marrë masat e duhura për transparencën e procesit të hartimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve.
3. Fillimin e diskutimit publik gjithëpërfshirës me synim ndryshimin e sistemit zgjedhor, përfshirë ndryshimet e nevojshme kushtetuese, brenda kohëzgjatjes së veprimtarisë së Komisionit.”

2. Pika III ndryshon si vijon:

“III. Anëtarësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e 12 (dhjetë) deputetëve të Kuvendit, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare.”

3. Pika IV ndryshon si vijon:

“IV. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga opozita parlamentare.”

4. Pika V ndryshon si vijon:

“V. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

1. Damian Gjikhuri	Bashkëkryetar	Grupi parlamentar PS
2. Rudina Hajdari	Bashkëkryetare	Grupi parlamentar “Demokrat”
3. Blerina Gjylameti	Anëtare	Grupi parlamentar PS
4. Klotilda Bushka	Anëtare	Grupi parlamentar PS
5. Bashkim Fino	Anëtar	Grupi parlamentar PS
6. Alket Hyseni	Anëtar	Grupi parlamentar PS
7. Vasilika Hysi	Anëtare	Grupi parlamentar PS
8. Korab Lita	Anëtar	Grupi parlamentar “Demokrat”
9. Arben Elezi	Anëtar	Grupi parlamentar “Demokrat”
10. Myslim Murrizi	Anëtar	Grupi parlamentar “Demokrat”
11. Nimet Musaj	Anëtar	Grupi parlamentar “I pavarur”
12. Ralf Gjoni	Anëtar	Grupi parlamentar “I pavarur”

5. Afati i veprimtarisë së Komisionit zgjatjet deri në datën 28 nëntor 2019.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën .2019